



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR  
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 714/2 /prot.

Tiranë, më 08.08.2024

**NJOFTIM**

**Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor**, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”, i ndryshuar, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së”, **shpall audicionin pozicionin e lirë të punës “Orkestrant i Kategorisë së Dytë (kontrabas)” pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.**

Për t’i dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për t’i krijuar mundësi pjesëmarrjes më të madhe në numër të konkurrentëve, TKOBAP-ja nxjerr njoftimin e saj ditën e sotme.

**Audicioni do të zhvillohet në datën 16.9.2024, ora 10:00, në sallën “Rifat Teqja” të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.**

**Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:**

1. Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën e provuar me dokumentacionin përkatës;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje të certifikuar nga shteti i tij;

6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.
7. Të ketë njohuri të mira gjuhëve të huaja (preferohet anglisht dhe italisht).

### **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të tyre:**

1. Letër shprehje interesi për pozicionin e punës së shpallur
2. Jetëshkrimi (CV)
3. Fotokopje të mjetit të identifikimit
4. Diploma, suplementi dhe lista e notave të noterizuara. Nëse aktualisht jeni në përfundim të studimeve të larta në nivelin Master për kontrabas, të depozitohet diploma Bachelor dhe lista e notave të noterizuara dhe një vërtetim se jeni në përfundim të studimeve. Në rast se arsimimi është kryer jashtë vendit, të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
5. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, tituj artistikë, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e aplikantit
6. Libreza e punës e noterizuar ose vërtetim mbi pagesën e kontributeve
7. Dëshmi e gjendjes gjyqësore
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore.

**Dokumentacioni të dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit ose i skanuar në adresën në postën elektronike zyrtare të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri në datën 9.9.2024 me objekt: Aplikim për pozicionin e punës “Orkestrant i Kategorisë së Dytë (kontrabas)”. Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e tyre sjell skualifikimin e aplikantit.**

### **Program i detvruar:**

1. Koncert Klasik me zgjedhje
  - J. Kr. Vanhal – Koncert në Re mazhor (ose versioni në Mi mazhor) koha parë
  - J. A. Hoffmeister – Koncert Nr.1 në Re mazhor/ koha parë
  - K. D. Dittersdorf – Koncert në Mi mazhor/ koha parë
2. Koncert Romantik
  - G. Bottesini – Koncert në Sib mazhor/ koha parë dhe e dytë

## Vështirësitë orkestrale

Otello  
Aida  
Flauti Magjik  
Rigoletto  
Traviata  
Don Giovanni  
Dasma e Figaros  
Forca e Fatit  
Beethoven Simfonia 5  
Beethoven simfonia 9  
Mozart simfonia 40  
Mahler simfonia 2

### Shënime:

- 1. Komisioni ruan të drejtën të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.**
- 2. Nëse aplikantët nuk do të kenë shoqërues në piano me vete, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambilit Popullor do të mundësojë një shoqërues në piano në ditën e audicionit pasi të jetë lajmëruar paraprakisht nga aplikanti në momentin e depozitimit të dokumentacionit.**
- 3. Pas verifikimit të dokumenteve të depozituara, aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet e-mail-it për zhvillimin e audicionit brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar për pozicionin e punës.**

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën e postës elektronike: [sekretaria@tkob.gov.al](mailto:sekretaria@tkob.gov.al).

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Abigeila Voshtina**

